



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
SP-020
Prishtinë, më 2 dhe 15 mars 2018

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 2 DHE 15 MARS 2018**

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2018.

Në fillim të seancës, kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli, propozoi që seanca fillimisht vetëm t'i shqyrtojë pikat e rendit, ndërsa ora 16:00 të caktohet për votimin e projektligjeve dhe më pas ora 19:00 për votimet e tjera. Diskutimi i plotë i kryetarit, z. Kadri Veseli, është i dhënë në transkript.

Kryetari kërkoi deklarinimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e tij.

Në lidhje me propozimin e lartcekur të kryetarit Veseli diskutuan: Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Ahmet Isufi në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi në emër të GP të “Nisma për Kosovën” dhe Albert Kinolli, në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Më pas, kryetari e hodhi në votim propozimin që seanca plenare, në orën 16:00, pas diskutimeve, të votohen projektligjet, si dhe në orën 19:00 të bëhen votimet tjera nga pikat e rendit të ditës.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi propozimin e lartshënuar.

Pastaj, kryetari procedoi me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, si në vijim.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Nezir Çoçaj, Xhelal Sveçla, Zafir Berisha, Islam Pacolli, Slobodan Petroviq, Blerta Deliu-Kodra, Frashër Krasniqi, Andin Hoti, Milaim Zeka, dhe Kadri Veseli, Kryetar i Kuvendit, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Haxhi Avdyli i parashtrroi pyetje ministres së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, në lidhje me gjendjen e shtratit të lumit Toplluha. Ministrja Albena Reshitaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Mimoza Kusari-Lila i parashtrroi pyetje ministres së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, në lidhje me ndërtimin e një objekti nga KRU “Radoniqi” në zonën e mbrojtur. Ministrja Albena Reshitaj iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Sala Berisha-Shala i parashtrroi pyetje ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, në lidhje me zbatimin e Ligjit për “Trepçën”. Ministri Valdrin Lluka nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Ganimete Musliu i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në lidhje me numrin e inspektorëve të punës dhe inspektimet në sektorin privat. Ministri Skender Reçica iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Rasim Selmanaj i parashtrroi pyetje ministrit të Administratës Publike, Mahir Jagcilar, në lidhje me pagat e kryesueseve dhe anëtarëve të kuvendeve komunale. Ministri Mahir Jagcila iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Teuta Haxhiu i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me nostrifikimin e diplomave të mësimdhënësve. Ministri Shyqiri Bytyqi iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Teuta Haxhiu i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me formimin e komisionit për vlerësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së universiteteve publike dhe për matjen e performances së kolegjeve private.

Ministri Shyqiri Bytyqi iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Rasim Selmanaj i parashtrroi pyetje ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në lidhje me aktivitetet e kësaj ministrie për zbatimin e Ligjit për sponsorizimet në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Ministri Kujtim Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi i parashtrroi pyetje ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në lidhje me konkursin për drejtor të Qendrës Kinematografike të Kosovës dhe përgjegjësinë e Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës lidhur me këtë konkurs.

Ministri Kujtim Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Nezir Çoçaj i parashtrroi pyetje ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikalo, në lidhje me planet e kësaj ministrie për tokat të cilat gjenden përreth shtratit të lumit Drini i Bardhë, që ato të kthehen për shfrytëzim bujqësor.

Ministri Nenad Rikalo iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Nezir Çoçaj i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me planet e kësaj ministrie për rritjen e buxhetit për universitetet publike, për rritje të numrit të profesorëve, për kërkime dhe hulumtime shkencore, si dhe për laboratorë.

Ministri Shyqiri Bytyqi iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Bekim Haxhiu i parashtrroi pyetje ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në lidhje me ndërmarrjen e veprimeve të kësaj ministrie për zbatimin e Ligjit parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive.

Ministri Kujtim Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Arbërie Nagavci i kishte parashtruar pyetje për përgjigje me shkrim ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me konkursin e kësaj ministri për “Shkencëtar i vitit 2017” dhe “Shkencëtari i ri i vitit 2017”.

Ministri Shyqiri Bytyqi nuk i ishte përgjigjur me shkrim pyetjes së deputetes në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

* * *

Në vazhdim, kryesuesi z. Haliti kërkoi deklarinimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare në lidhje me procedimin e mëtejshëm të pikave të rendit të ditës, pasi nuk kishte kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Në lidhje me çështjen e ngritur nga z. Haliti, diskutuan: Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Elmi Reçica, në emër të GP të PDK-së; Ahmet Isufi në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi në emër të GP të “Nisma për Kosovën”; Albert Kinolli, në emër të GP “6+”; nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala, si dhe deputetët: Memli Krasniqi, Emilija Rexhepi dhe Teuta Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutime, për shkak të mungesës së kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, kryesuesi dha pauzë.

* * *

Pas pauzës, në orën 15:00, kryesuesi konstatoi se në seancë janë të pranishëm 62 deputetë dhe procedoi me punimet e seancës.

Më pas, për fjalë u paraqit deputeti Imet Rrahmani, i cili propozoi që pika e 18 e rendit të ditës - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën, të hiqet nga rendi i ditës, pasi Komisioni Funkcional nuk e ka proceduar në Kuvend raportin për këtë projektligj.

Në lidhje me propozimin e lartshënuar të deputetit Imet Rrahmani, kryesuesi konstatoi se pika 18 e rendit të ditës - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën, hiqet nga rendi i ditës i kësaj seance plenare.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching Spark-ut të Holandës (SPARK) për mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi, e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching Spark-ut të Holandës (SPARK) për mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching Spark-ut të Holandës (SPARK) për mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit

Mitrovica, diskutuan deputetët: Teuta Haxhiu, në emër të Komisionit Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi dhe në emër të GP të AAK-së; Valentina Bunjaku-Rexhepi, në emër të GP të LDK-së; Nezir Çoçaj, në emër të GP të PDK-së; Albulena Balaj-Halimaj, në emër të GP të “Nisma për Kosovën”; Mufera Shinik, në emër të GP “6+”, Nait Hasani, Islam Pacolli, Milaim Zeka, Naser Rugova dhe Muharrem Nitaj, si dhe Kryeministri i Kosovës, z. Ramush Haradinaj dhe Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi konstatoi se për mungesë të kuorumit të mjaftueshëm, procedimi për votim i këtij projektligji shtyhet në vazhdimin e kësaj seance, kur të arrihet kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje.

Procedimi për votimin e këtij projektligji është bërë në seancën plenare, më 15 mars 2018.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se në votim morën pjesë 71 deputetë, që nuk përbënte kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim, ADA

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi, e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim, ADA, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim Ada, diskutuan deputetët: Teuta Haxhiu, në emër të Komisionit Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi dhe në emër të GP të AAK-së; Valentina Bunjaku-Rexhepi, në emër të GP të LDK-së; Nezir Çoçaj, në emër të GP të PDK-së; Albulena Balaj-Halimaj, në emër të GP të “Nisma për Kosovën” dhe Mufera Shinik, në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi konstatoi se për mungesë të kuorumit të mjaftueshëm, procedimi për votim i këtij projektligji shtyhet në vazhdimin e kësaj seance, kur të arrihet kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje.

Procedimi për votimin e këtij projektligji është bërë në seancën plenare, më 15 mars 2018.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 80,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Ligji Nr. 06/L-053 për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim, ADA Ref. no. 8116-00/2016/Lr2016.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA)

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA) dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Administratës Publike, Mahir Jagcilar, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA), diskutuan deputetët: Nait Hasani, në emër të Komisionit Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media; Imet Rrahmani, në emër të GP të LDK-së; Xhevahire Izmaku, në emër të GP të PDK-së; Rasim Selmanaj, në emër të GP të AAK-së; Milaim Zeka, në emër të GP të “Nisma për Kosovën” dhe Albert Kinolli, në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Procedimi për votimin e këtij projektligji është bërë në Seancën plenare, më 15 mars 2018.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se në votim morën pjesë 77 deputetë, që nuk përbënte kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për miniera dhe minerale

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, e ka shqyrtuar Projektligjin për miniera dhe minerale dhe Kuvendit i aka rekomanduar miratimin e tij.

Kryetarja Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, Sala-Berisha Shala, në emër të komisionit si propozues i projektligjit, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për Miniera dhe Minerale, diskutuan deputetët: Sala-Berisha Shala në emër të GP të PDK-së; Enver Hoti, në emër të GP të “Nisma për Kosovën”, dhe Duda Balje, në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi konstatoi se për mungesë të kuorumit të mjaftueshëm, procedimi për votim i këtij projektligji shtyhet në vazhdimin e kësaj Seance, kur të arrihet kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje.

Procedimi për votimin e këtij projektligji është bërë në seancën plenare, më 15 mars 2018.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 54,
Kundër ----- 9,
Abstenime ----- 7.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-027 për miniera dhe minerale.
2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i

ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034, diskutuan deputetët: Hajdar Beqa, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe në emër të GP të PDK-së; Arben Gashi, në emër të GP të LDK-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të “Nisma për Kosovën”, dhe Bahrim Shabani, në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari konstatoi se për mungesë të kuorumit të mjaftueshëm, procedimi për votim i këtij projektligji shtyhet në vazhdimin e kësaj seance, kur të arrihet kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje.

Procedimi për votimin e këtij projektligji është bërë në seancën plenare, më 15 mars 2018.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 52,
Kundër ----- 22,
Abstenime ----- 2.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi e ka shqyrtuar Projektligjin për

Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, diskutuan deputetët: Teuta Haxhiu, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi dhe në emër të GP të AAK-së; Valentina Bunjaku-Rexhepi, në emër të GP të LDK-së; Nezir Çoçaj, në emër të GP të PDK-së; Albulena Balaj-Halimaj, në emër të GP të “Nisma për Kosovën”; Mufera Shinik, në emër të GP “6+” dhe Bekim Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari konstatoi se për mungesë të kuorumit të mjaftueshëm, procedimi për votim i këtij projektligji shtyhet në vazhdimin e kësaj Seance, kur të arrihet kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje.

Procedimi për votimin e këtij projektligji është bërë në seancën plenare, më 15 mars 2018.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 70,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 7.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.
2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, e ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit, diskutuan deputetët: Memli Krasniqi, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal dhe Bilall Sherifi, në emër të GP të “Nisma për Kosovën”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari konstatoi se për mungesë të kuorumit të mjaftueshëm, procedimi për votim i këtij projektligji shtyhet në vazhdimin e kësaj Seance, kur të arrihet kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje.

Procedimi për votimin e këtij projektligji është bërë në seancën plenare, më 15 mars 2018.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 78,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 2.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produkte të ndërtimit

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, e ka shqyrtuar Projektligjin për produkte të ndërtimit dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për produkte të ndërtimit, diskutuan deputetët: Memli Krasniqi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal dhe në emër të GP të PDK-së; Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së dhe Bilall Sherifi, në emër të GP të “Nisma për Kosovën”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari konstatoi se për mungesë të kuorunit të mjaftueshëm, procedimi për votim i këtij projektligji shtyhet në vazhdimin e kësaj seance, kur të arrihet kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje.

Procedimi për votimin e këtij projektligji është bërë në Seancën plenare, më 15 mars 2018.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 76,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 2.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-033 për produkte të ndërtimit.
2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi, e ka shqyrtuar Projektligjin për inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyeoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë, diskutuan deputetët: Teuta Haxhiu, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Shkencë,

Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi dhe në emër të GP të AAK-së dhe Abdyl Salihu, në emër të GP të PDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari konstatoi se për mungesë të kuorunit të mjaftueshëm, procedimi për votim i këtij projektligji shtyhet në vazhdimin e kësaj Seance, kur të arrihet kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje.

Procedimi për votimin e këtij projektligji është bërë në seancën plenare, më 15 mars 2018.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 77,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 2.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-049 për inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë.
2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, e ka shqyrtuar Projektligjin për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, diskutuan deputetët: Memli Krasniqi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal dhe në emër të GP të PDK-së dhe Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari konstatoi se për mungesë të kuorumit të mjaftueshëm, procedimi për votim i këtij projektligji shtyhet në vazhdimin e kësaj seance, kur të arrihet kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje.

Procedimi për votimin e këtij projektligji është bërë në seancën plenare, më 15 mars 2018.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 76,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 2.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimet postare

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, e ka shqyrtuar Projektligjin për shërbimet postare dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Në emër të Qeverisë, Ministri Bajram Hasani, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për shërbimet postare, diskutuan deputetët: Memli Krasniqi, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal dhe në emër të GP të PDK-së dhe Bekë Berisha, në emër të GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari konstatoi se për mungesë të kuorumit të mjaftueshëm, procedimi për votim i këtij projektligji shtyhet në vazhdimin e kësaj Seance, kur të arrihet kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje.

Procedimi për votimin e këtij projektligji është bërë në seancën plenare, më 15 mars 2018.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për ----- 70,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 6.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-038 për shërbimet postare.
2. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për metrologji

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, e ka shqyrtuar Projektligjin për metrologji dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për Metrologji, diskutuan deputetët: Sala Berisha-Shala, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal dhe në emër të GP të PDK-së; dhe Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari konstatoi se për mungesë të kuorunit të mjaftueshëm, procedimi për votim i këtij projektligji shtyhet në vazhdimin e kësaj seance, kur të arrihet kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje.

Procedimi për votimin e këtij projektligji është bërë në seancën plenare, më 15 mars 2018.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 76,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-037 për metrologji.
2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, e ka shqyrtuar Projektligjin për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Në emër të Qeverisë, zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, diskutuan deputetët: Nait Hasani, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media; Xhevahire Izmaqu, në emër të GP të PDK-së; Rasim Selmanaj, në emër të GP të AAK-së; Igor Simiq, në emër të GP të Listës Serbe, Milaim Zeka, në emër të GP të “Nisma për Kosovën”; Korab Sejdiu dhe Islam Pacolli, si dhe Ministri i Administratës Publike, Mahir Jagxhilar, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari konstatoi se për mungesë të kuoromit të mjaftueshëm, procedimi për votim i këtij projektligji shtyhet në vazhdimin e kësaj seance, kur të arrihet kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje.

Procedimi për votimin e këtij projektligji është bërë në seancën plenare, më 15 mars 2018.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 66,
Kundër ----- 9,
Abstenime ----- 4.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare.

2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gjak dhe përbërës të gjakut

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, e ka shqyrtuar Projektligjin për gjak dhe përbërës të gjakut dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Në emër të Qeverisë, Ministri Abelard Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për gjak dhe përbërës të gjakut, diskutuan deputetët: Bekim Haxhiu, në emër të GP të PDK-së; Time Kadrijaj, në emër të GP të AAK-së dhe Fikrim Damka, në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari konstatoi se për mungesë të kuoromit të mjaftueshëm, procedimi për votim i këtij projektligji shtyhet në vazhdimin e kësaj seance, kur të arrihet kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje.

Procedimi për votimin e këtij projektligji është bërë në seancën plenare, më 15 mars 2018.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 72,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjakut.

2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat mbrojtëse në importe

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, e ka shqyrtuar Projektligjin për masat mbrojtëse në importe dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin për masat mbrojtëse në importe, diskutuan deputetët: Sala Berisha-Shala, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal dhe në emër të GP të PDK-së; Mimoza Kusari-Lila, në emër të GP të LDK-së; Bekë Berisha, në emër të GP të AAK-së dhe Bilall Sherifi, në emër të GP të “Nisma për Kosovën”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari konstatoi se për mungesë të kuorumit të mjaftueshëm, procedimi për votim i këtij projektligji shtyhet në vazhdimin e kësaj seance, kur të arrihet kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje.

Procedimi për votimin e këtij projektligji është bërë në seancën plenare, më 15 mars 2018.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 62,
Kundër ----- 8,
Abstenime ----- 5.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-040 për masat mbrojtëse në importe.
2. Ngarkohet Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

* * *

24. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 07/21, datë 22.12.2017 në lidhje me Pallatin e Rinisë në Prishtinë

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, e ka shqyrtuar Propozim-Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 07/21, datë 22.12.2017, në lidhje me Pallatin e Rinisë në Prishtinë, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar shqyrtimin e tij.

Në emër të Qeverisë, zëvendëskryeministri, Enver Hoxhaj, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 07/21, datë 22.12.2017, në lidhje me Pallatin e Rinisë në Prishtinë. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë propozim-vendim.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e këtij propozim-vendimi të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 07/21, dt. 22.12.2017.

Lidhur me propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 07/21, datë 22.12.2017 në lidhje me Pallatin e Rinisë në Prishtinë, diskutuan deputetët: Sala Berisha-Shala, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal; Daut Haradinaj, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të “Nisma për Kosovën”; Islam Pacolli; Korab Sejdiu dhe Milaim Zeka, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryetari i Kuvendit kërkoi nga të gjitha komisionet parlamentare, që në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, kur t’i shqyrtojnë çështjet për të cilat ngarkohen, duhet t’i paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim ose për mosmiratim e çështjeve, e jo vetëm të rekomandojnë shqyrtimin e tyre, si në rastin e Raportit të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, për këtë propozim-vendim.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari konstatoi se për mungesë të kuorumit të mjaftueshëm, procedimi për votim i këtij propozim-vendimi shtyhet për më vonë.

Votimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 07/21, datë 22.12.2017, është bërë në seancën plenare, më 15 mars 2018.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 73,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Ndërmarrja Shoqërore “Qendra Shoqërore Sportive, Kultureore dhe Ekonomike Pallati i Rinisë- PRNO67”, hiqet nga kompetenca e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Autorizohet Qeveria e Republikës së Kosovës, që këtë ndërmarrje dhe asetet e saj, ta regjistrojë si Ndërmarrje Publike Lokale.

25. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë propozim-vendim.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari konstatoi se për mungesë të kuorumit të mjaftueshëm, procedimi për votimin e propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës, shtyhet në vazhdimin e kësaj seance, kur të arrihet kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje.

Procedimi për votimin e këtij propozim-vendimi është bërë në seancën plenare, më 15 mars 2018.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 55,

Kundër ----- 14,

Abstenime ----- 4.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Emërohen anëtarët e Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës:

1. Z. Aleksandër Lumezi, kryetar i komisionit, pyetës për lëndën: E Drejta Penale, ndërsa zëvendësanëtar i komisionit z. Besim Kelmendi;
2. Z. Haxhi Gashi, anëtar i komisionit, pyetës për lëndën: E Drejta Civile (materiale dhe procedurale), ndërsa zëvendësanëtar i komisionit z. Albert Zogaj;
3. Z. Nebojsa Boriçiq, anëtar i komisionit, pyetës për lëndën: E Drejta Tregtare,

ndërsa zëvendësanëtar i komisionit z. Gazmend Nushi;

4. Znj. Afërdita Bytyçi, anëtare e komisionit, pyetës për lëndën: E Drejta Kushtetuese, Organizimi i Sistemit Gjyqësor të Kosovës, Bazat e Sistemit të Bashkimit Evropian dhe të Drejtat e Njeriut, ndërsa zëvendësanëtar i komisionit z. Qerim Fazliji;
5. Z. Enver Peci, anëtar i komisionit, pyetës për lëndën: E Drejta e Punës dhe E drejta Administrative, ndërsa zëvendësanëtare e komisionit znj. Emine Kaçiku.

II. Mandati i të emëruarve në Komisionin për Dhënie e Provimit të Jurisprudencës, sipas pikës (I) të këtij vendimi, është (2) dyvjeçar.

Kryetari i ndërpreu punimet e seancës plenare në orën 18:35 minuta, ndërsa për vazhdimin e kësaj seance do të vendosë Kryesia e Kuvendit.

* * *

E enjte më 15 mars 2018

Vazhdimi i seancës plenare, e filluar më 2 mars 2018

Kryesuesi z. Xhavit Haliti, procedoi me pikat e papërfunduara, si në vijim:

18. Votimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016

Kryesuesi i njoftoi deputetët se për këtë çështje diskutimet kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 9 shkurt 2018, por në mungesë të kuorumit për vendimmarrje votimi është shtyrë.

Andaj, sot vazhdojmë me procedimin e votimit të raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 49,
Kundër ----- 8,
Abstenime ----- 3.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016.

19. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shoqëritë tregtare

Kryesuesi i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për shoqëritë tregtare dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Në këtë projektligj ishin propozuara gjithsej 26 amendamente.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto amendamente: 1, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 23, 25 dhe 26.

Deputeti Korab Sejdiu e tërhoqi amendamentin 24.

Kuvendi nuk i miratoi amendamentet 2, 21 dhe 22.

Më pas, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 68,
Kundër ----- 3,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare.

20. Përzgjedhja e një (1) kandidati për pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar listën e kandidatëve të përzgjedhur nga Paneli Përzgjedhës i Bankës Qendrore për guvernator të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar përzgjedhjen e njërit prej kandidatëve e propozuar.

Pastaj, kryesuesi e ftoi kryetarin e Komisionit Funksional për Buxhet dhe Financa që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë raportin e Komisionit.

Lumir Abdixhiku, kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e Komisionit Funksional.

Në vazhdim, kryesuesi kërkoi nga grupet parlamentare, që ta propozojnë nga një anëtar në Komisionin votues, për të zhvilluar procedurat e votimit të fshehtë.

Me propozimin e grupeve parlamentare, Kuvendi e zgjodhi Komisionin votues në këtë përbërje:

Fidan Rekaliu, GP - LDK,
Xhevahire Izmaku, GP - PDK,
Saranda Bogujevci, GP - LVV,
Faton Topalli, GP - “Deputetët e Pavarur”,
Rasim Selmanaj, GP -AAK,
Srgjan Petroviq, GP - Lista serbe,
Haxhi Shala, GP - “Nisma për Kosovën” dhe
Bahrim Shabani, GP - “6+”.

Kryesuesi i ftoi anëtarët e Komisionit votues që të fillojnë me procedurat e votimit të fshehtë për përzgjedhjen e një (1) kandidati për pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Pastaj, kryesuesi i ftoi sipas listës deputetët e Kuvendit për të votuar.

Pas zhvillimit të procedurës së votimit të fshehtë, në emër të Komisionit votues rezultatin e votimit për përzgjedhjen e një (1) kandidati për pozitën e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, e paraqiti deputetja Xhevahire Izmaku.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:
Në votim kishin marrë pjesë 110 deputetë.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar ishin, si në vijim:

1. Fehmi Mehmeti, 60 vota,
2. Shkëndije Himaj, 15 vota,
3. Besnik Bislimi, 31 vota dhe
4. Safet Merovci, 4 vota.

Kryesuesi konstatoi se në bazë të rezultateve të votimit dhe në mbështetje të neneve në 65 (9) dhe 140 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi me votim të fshehtë mori këtë:

V E N D I M

1. Z. Fehmi Mehmeti përzgjidhet guvernator i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
2. Vendimi i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për emërimin e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

21. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e dy (2) anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Kryesuesi propozoi që të procedohet përnjëherë me votimin e fshehtë për pikat e rendit të ditës: 21. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e dy (2) anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë; 22. Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe 23. Zgjedhja e një (1) anëtari të Bordit për Ankesa.

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare e mbështetën propozimin e kryesuesit z. Haliti, që Kuvendi përnjëherë të procedoj me votimin e fshehtë të tri pikave lartpërmendura të rendit të ditës.

Në vazhdim, kryesuesi kërkoi nga grupet parlamentare, që ta propozojnë nga një anëtar në Komisionin votues, për të zhvilluar procedurat e votimit të fshehtë.

Me propozimin e grupeve parlamentare, Kuvendi e zgjodhi Komisionin votues në këtë përbërje:

Fidan Rekalju, GP - LDK,
Xhevahire Izmaku, GP - PDK,
Valon Ramadani, GP - LVV,
Frashër Krasniqi, GP - “Deputetët e Pavarur”,
Rasim Selmanaj, GP -AAK,
Jelena Bontiq, GP - Lista serbe,
Enver Hoti, GP - “Nisma për Kosovën” dhe
Bahrim Shabani, GP - “6+”.

Në vazhdim, kryesuesi i njoftoi të pranishmit se Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, e ka shqyrtuar listën e kandidatëve për anëtarët e Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë - ZRRE, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të këtij Bordi, nga kandidatët e propozuar.

Pastaj, kryesuesi e ftoi kryetaren e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë raportin e Komisionit.

Znj. Sala Berisha-Shala, kryetare e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e Komisionit Funksional.

* * *

Në vazhdim, kryesuesi i njoftoi të pranishmit se Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidateve për dy (2) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, i ka shqyrtuar biografite dhe i ka zhvilluar intervistat me kandidatët dhe Kuvendit i ka rekomanduar zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të këtij Bordi, nga katër (4) kandidatët e propozuar.

Pastaj, kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit ad hoc, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë raportin e Komisionit.

Z. Imet Rrahmani, kryetar i Komisionit ad hoc, për përzgjedhjen e kandidateve për dy (2) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin.

* * *

Më pas, kryesuesi i njoftoi të pranishmit se Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidateve për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa, i ka shqyrtuar biografite dhe i ka zhvilluar intervistat me kandidatët dhe Kuvendit i ka rekomanduar zgjedhjen e një (1) anëtari të këtij Bordi, nga dy (2) kandidatet e propozuar.

Pastaj, kryesuesi e ftoi kryetaren e Komisionit ad hoc, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë raportin e Komisionit.

Znj. Xhevahire Izmaku, kryetare e Komisionit Ad-Hoc, për përzgjedhjen e kandidateve për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e Komisionit.

* * *

Kryesuesi i ftoi anëtarët e Komisionit votues, që të fillojnë me procedurat e votimit të fshehtë për emërimin e dy (2) anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë; për zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe për zgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit për Ankesa.

Pastaj, kryesuesi i ftoi sipas listës deputetët e Kuvendit për të votuar.

Pas zhvillimit të procedurës së votimit të fshehtë, në emër të Komisionit votues, rezultatin e votimit për emërimin e dy (2) anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, e paraqiti deputeti Rasim Selmanaj.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

- Në votim kishin marrë pjesë 108 deputetë.
- Të pavlefshme ishin 2 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar ishin, si në vijim:

1. Bekim Jakupi, 27 vota,
2. Fadil Ismajli, 33 vota,
3. Izet Rushiti, 56 vota dhe
4. Selman Hoti, 75 vota.

Kryesuesi konstatoi se në bazë të rezultateve të votimit dhe në mbështetje të nenit 65 (9) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 67 të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 5 të Ligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, në Seancën plenare të mbajtur më 15 mars 2018, me propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me votim të fshehtë, mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e dy (2) anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE)

Selman Hoti dhe Izet Rushiti emërohen anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), me mandat pesë (5) vjeçar.

* * *

Pas zhvillimit të procedurës së votimit të fshehtë, në emër të Komisionit votues, rezultatin e votimit për zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Bordit Radiotelevizionit të Kosovës, e paraqiti deputeti Frashër Krasniqi.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

- Në votim kishin marrë pjesë 108 deputetë.
- Të pavlefshme ishin 16 vota.

I. Votat e fituara për kandidatët e propozuar për emërimin e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar ishin, si në vijim:

1. Çun Lajçi, 28 vota,
2. Shkodran Tolaj, 45 vota.

II. Votat e fituara për kandidatët e propozuar për emërimin e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radhët e komunitetit serb ishin, si në vijim:

1. Marijana Adamoviq-Shimiç, 55 vota,
2. Nebojsa Periq, 2 vota.

Kryesuesi konstatoi se në bazë të rezultateve të votimit dhe në mbështetje të nenit 65 (9) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 67 të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 26 pika 2.4 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, në Seancën plenare të mbajtur më 15

mars 2018, me Rekomandimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, me votim të fshehtë, mori këtë:

V E N D I M

Për zgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

1. Znj. Marijana Adamoviq-Shimiç zgjidhet anëtare e Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radhët e komunitetit serb, me mandat tre (3) vjeçar.
2. Kandidatët e propozuar: Çun Lajçi dhe Shkodran Tolaj, për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radhët e komunitetit shqiptar, asnjëri nuk i morën votat e nevojshme për tu zgjedhur anëtar i këtij Bordi.
3. Të përsëritet konkursi për zgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar.

* * *

Pas zhvillimit të procedurës së votimit të fshehtë, në emër të Komisionit votues, rezultatin e votimit për zgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit për Ankesa, e paraqiti deputetja Xhevahire Izmaku.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

- Në votim kishin marrë pjesë 108 deputetë.
- Të pavlefshme ishin 5 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar ishin, si në vijim:

1. Ilaz Rudaku, 90 vota,
2. Florim Shefqeti, 13 vota,

Kryesuesi konstatoi se në bazë të rezultateve të votimit dhe në mbështetje të nenit 65 (9) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 70.1 të Rregullores së Kuvendit dhe të 38, 39 dhe 40 të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave, në seancën plenare të mbajtur më 15 mars 2018, me propozim të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa, me votim të fshehtë, mori këtë:

V E N D I M

Z. Ilaz Rudaku zgjidhet anëtar i Bordit për Ankesa, me mandat tre (3) vjeçar.

26. Debat parlamentar sipas kërkesës të nënkryetarit të Kuvendit, z. Kujtim Shala dhe pesë (5) deputetëve nënshkrues për debat parlamentar lidhur me takimin IV të përbashkët të Komisionit Parlamentar të Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim, BE-Kosovë, të mbajtur më 17-19 janar 2018, në Strasburg (Francë)

Kryesuesi e ftoi parashtruesin e kërkesës për debat parlamentar që ta marrë fjalën.

Deputetit Arben Gashi, në emër të parashtruesit të kërkesës, deklaroi se e tërheqin kërkesën për debat parlamentar për këtë çështje me arsyetimin se ajo tani e ka humbur aktualitetin.

27. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për zëvendësimin e deputetëve në komisionet parlamentare

Me propozim e deputetes Albulena Haxhiu kjo pikë u shty për një afandë e radhës.

28. Formimi i Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e një (1) anëtari nga radhët e komunitetit shqiptar dhe dy (2) anëtarëve nga radhët e komuniteteve joshqiptare të Komisionit të Pavarur të Medieve

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e grupeve parlamentare për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtari nga radhët e komunitetit shqiptar dhe dy (2) anëtarëve nga radhët e komuniteteve joshqiptare të Komisionit të Pavarur të Medieve

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 63,
Kundër ----- 3,
Abstenime ----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtari nga radhët e komunitetit shqiptar dhe dy (2) anëtarëve nga radhët e komuniteteve joshqiptare të Komisionit të Pavarur të Mediave, në këtë përbërje:

1. Fisnik Ismaili, nga GP “Deputetët e Pavarur”, kryetar,
2. Rasim Selmanaj, nga GP i AAK-së, zv/kryetar i parë,
3. Jelena Bontiq, nga GP i Listës Serbe, zv/kryetare e dytë,
4. Imet Rrahmani, nga GP i LDK-së, anëtar,
5. Arban Abrashi, nga GP i LDK-së, anëtar,
6. Nait Hasani, nga GP i PDK-së, anëtar,

7. Ganimete Musliu, ... nga GP i PDK-së, anëtare,
8. Adem Mikullovc, ... nga GP i LVV-së, anëtar,
9. Valon Ramadani,..... nga GP i LVV-së, anëtar,
10. Milaim Zeka,..... nga GP “Nisma për Kosovën”, anëtar dhe
11. Albert Kinolli, nga GP “6+”, anëtar.

II. Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar nga radhët e komunitetit shqiptar dhe dy (2) anëtarëve nga radhët e komuniteteve jo-shqiptare të Komisionit të Pavarur të Medieve, duhet të veprojë në përputhje me nenin 11, paragrafi 2.2 të Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Medieve dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

* * *

29. Votimi i propozim-rezolutës në lidhje me dhunën në familje dhe adresimin institucional

Kryetari i njoftoi deputetët se për këtë çështje, diskutimet kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 8 mars 2018, por në mungesë të kuorumit për vendimmarrje votimi është shtyrë.

Andaj, sot vazhdojmë me procedimin e votimit të rekomandimeve në lidhje me dhunën në familje dhe adresimin institucional.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 69,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 1.

Kuvendi miratoi këto:

R E K O M A N D I M E

1. Rishikimi dhe plotësimi i Ligjit 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje;
2. Ndryshimi në Kodin Penal dhe të procedurës penale për veprën penale të dhunës në familje, si dhe fuqizimi i mekanizmit koordinues për parandalimin dhe ndjekjen penale të dhunës në familje, përfshirë dëmshpërblimin për dëmet emocionale të viktimave të dhunës në familje dhe viktimave në baza gjinore;
3. Të zbatohet në tërësi strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe plani i veprimit 2016/2020, sidomos nenet që kanë të bëjnë me riintegrimin e viktimave të dhunës në familje, si dhe rishikimi i këtyre dokumenteve për të reflektuar ndryshimin në legjislacionin konform pikave 1 dhe 2 të kësaj rezolute;

4. Avancimi i korrikulave arsimore për edukimin e nxënësve për rëndësinë e barazisë gjinore, si dhe eliminimi i rasteve në korrikula, ku referohet dhuna në familje si mjet komunikimi;
5. Përfshirja e strehimoreve në planifikimin e ardhshëm buxhetor për vitin 2019 dhe shqyrtimi i mundësisë për ndihmë të jashtëzakonshme me rishikim të buxhetit për vitin 2018;
6. Avancimi i buxhetimit të plotë gjinor në të gjitha institucionet;
7. Programe të qarta dhe marrje parasysh e aspekteve të barazisë gjinore në ministritë e linjës, që mbështesin gratë në biznes dhe punësim, përfshirë programe për riaftësim profesional dhe inkuadrim të grave në tregun e punës;
8. Mbështetje politike për programe sociale dhe strehim të viktimave, do të thotë strehim afatgjatë të viktimave të dhunës në familje; dhe
9. Mbështetje e qendrave për punë sociale për ofrimin e shërbimeve këshilluese për familje si masë e parandalimit të dhunës dhe ndarjeve të familjes.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare më 15 mars 2018, në orën 17:00.

Kryetari i Kuvendit:
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*